



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:028247

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766717

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Driton Sadiku, me bashkëpunëtorin profesional Sefedin Avdijaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK-së), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/IL.nr.308/2023, të datës 24.01.2024, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datën 27.05.2024, në prezencën e prokurores së shtetit Shqiponja Jupa, të akuzuarit A. M., me datën 27.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 31.05.2024 e përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. M., nga i ati R., e ëma V, e vajzërisë C, data e lindjes . . . , në Gjakovë, ku edhe tani banon në rr. “. . .”, p.n, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, menaxher në . . . , i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 20.02.2022, rreth orës 16:30 minuta, në rr. “Nënë Tereza”, në Gjakovë, përballë hyrjes së fabrikës “. . .”, i pandehuri me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit A. K. nga Gjakova, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri si udhëheqësi i zyrës ligjore “. . .”, e kishte ftuar të dëmtuarin që të paraqitet tek zyra ligjore, me ç’ rast edhe i kumton lajmin se është pushuar nga puna, për të cilin fakt i dëmtuari nuk pajtohet dhe të pandehurin e pret tek

hyrja e fabrikës “. . .” për tu sqaruar lidhur me pushimin e tij nga puna, ku fillimisht fjalosen mes vete duke shkëmbyer fjalë mosmirënjohëse mes veti edhe përkundër faktit se kishin miqësi dhe në atë momente i pandehuri revoltohet dhe e godet me shuplakë në kokë të dëmtuarin, duke i shkaktuar ndrydhje të indeve të buta të kokës, të cilat lëndime bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme për shëndetin, të përshkruara më për afërsisht si në akt ekspertizën mjeko ligjore të dr.D.H., ekspert mjeko ligjor, me numër të referencës Gj-199/23, të datës 20.08.2023.

- me këto veprime ka kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 185 par.1 nën par.1.4 të Kodit Penal të Kosovës, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të akuzuarin e:

## G J Y K O N

- I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej treqind (300.00) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë të akuzuarit dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga njëzet (20) euro.
- III. I dëmtuari A. K. nga Gjakova, . . . , për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.
- IV. Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës për ekspertizën mjeko – ligjore, në shumë prej nga njëzet (20.00) euro, shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30.00) euro, si dhe taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20.00) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### *1.Ecuria e procedurës penale*

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.308/2023, të datës 24.01.2024, ndaj të akuzuarit I.S.nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par 1.4. të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 27.05.2024 në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Shqiponja Jupa, si dhe i akuzuari. Në këtë shqyrtim prokurori i shtetit ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari, A. M., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, shton se jam penduar për veprën që ka ndodhur nuk ka qenë dashur të ndodhë ashtu, mirëpo paksa kam qenë i provokuar nga i dëmtuari, i cili pasi është pushuar nga puna më ka pritur jashtë dhe ka qenë i revoltuar me mua, më është ofruar shumë dhe për këtë arsye ka ndodhur ajo që ka ndodhur, për të cilën sigurisht që jam pishman.

Prokurorja e shtetit, Shqiponje Jupa, duke dhënë mendim rreth pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për favoret dhe pasojat e pranimi të fajësisë, po ashtu ky pranim gjen mbështetje të plotë edhe në prova që e mbështesin aktakuzën, andaj gjykatës i propozoi që pranimi i fajësisë si shprehje të lirë të vullnetit të pranoj dhe të akuzuarit ti shqiptoi në dënim të merituar konform ligjit. Ndërsa lidhur me caktimin dhe llojin e lartësisë se dënimit gjykatës i ka propozuar gjykatës që si rrethanë rënduese të merret shkalla e dashjes së të pandehurit në kryerjen e ke saj vepre penal e që këtë prokurori i shtetit e bazon në mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale, ku i pandehuri përmes shuplakës e godet në kokë të dëmtuarin në fytyrën në këtë mënyrë absorbohet shkalla e lartë e dashjes. Ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, të bërë nga i pandehuri A. M. pendesa për kryerjen e kësaj vepre penale, po ashtu i propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare të verifikon nëse i akuzuari A. M. ka të kaluarën penale dhe varësisht se çka

rezulton e njëjta të merret si rrethanë lehtësuese apo rënduese, po ashtu të pandehuri të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

## *2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shteti dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

## *3. Gjendja faktike e vërtetuar*

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari A. M., me dashje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par 1.4. të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## *4. Elementet e veprës penale*

Në nenin 185 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale dhuna në familje e kryen: “ *Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor i cili rezulton në: dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.* ”

### *5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues*

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin I.S.e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par 1.4. të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

### *6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit*

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethana lehtësuese që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana: sjellja e tij ka qenë tejet korrekte me gjykatën duke shprehur pendim për veprën e kryer, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nga evidenca penale nuk rezulton se më herët ka kryer ndonjë vepër penale, gjithashtu edhe në deklarimin e tij në shqyrtim fillestar ka deklaruar kjo është hera e parë që ka kryer një vepër penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris më ndonjë vepër penale, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet.

Ndërsa si rrethanë rënduese jashtë elementeve të veprës penale gjykata nuk ka gjetur në këtë rast.

Kështu që duke marr parasysh rrethanat e lartpërmendura, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga

kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### *7. Kërkesën pasurore juridike*

Gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 462 par.2 të KPP-së, të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil për realizimin e kërkesës së tyre juridiko – pasurore.

### *8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa për taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 par.3 nën par.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 364 të KPP-së.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

*Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal*

2024:028247, me datën 31.05.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Sefedin Avdijaj

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Driton Sadiku

**UDHËZIMI JURIDIK:** *Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.*